



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.198/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Adnan Konushevci dhe Afijete Sada - Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Euroatlantike e Kosovës, me seli në Prishtinë, për shkak të shpërndarjes së materialit zgjedhor në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.10.2019, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.198/2019 e datës 03.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Euroatlantike e Kosovës PEK, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datën 03.10.2019, Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 03 Tetor 2019 rreth orës 09:00, përgjatë rrugës “Bill Clinton” në afërsi të rezidencës së Ipushkvisë gjenden materiale promovuese të subjektit politik Partia Euroatlantike e Kosovës PEK, me këtë veprim kanë bërë shkeljen e Rregullës 13/2013 neni3 pika 3.4

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të printuar.

Në përgjigjen në ankesë të datës 03.10.2019, subjekti politik PEK, thekson se kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Arbër Zeka është kandidat nga Komuna e Gjakovës dhe e vizitkartat të cilat gjenden në rrugë nuk paraqesin kurrfarë dëshmie për shkelje të rregullave zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se: **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, vendimet e tij i bazon në dëshmi qarta dhe bindëse siç është përcaktuar me nenin 117 paragrafi 3 i LZP-së, e që në rastin konkret fotografitë e ofruara dhe CD nga ankuesi, lidhur me shpërndarjen materialeve zgjedhore-vizitkartat në rrugët publike për panelin është e paqartë dhe nuk është bindëse për të vendosur ndryshe në këtë rast, ngase për vizitkartat e shpërndara nuk mund të identifikohet personi i cili ka bërë shpërndarjen e tyre. Andaj paneli

erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme përshkrimet në ankesë se është thyer Rregulla 13/2013 neni 3 pika 3.4 nga subjekti politik PEK.

Më këtë rast paneli konsideron se parashtuesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij të paraqitura në ankesë.

Nga arsyet e theksuara si më lart e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, neni 117 paragrafi 3 neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me nenin 5 paragrafi 7 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

Anr.198/2019 më datën 05.10.2019



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.